



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3074 Prot.

Tiranë, më 22.12.2025

VENDIM QARKULLUES

Nr. 69 Datë 22.12 2025

**“PËR
MIRATIMIN E FINANCIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHPENZIMEVE TË
PROJEKTIT "GEIN - FEMALE SPORT LEADERS PROMOTING GENDER
INDEPENDENT PHYSICAL ACTIVITY" NGA TË ARDHURAT DYTËSORE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 49, gërma c, të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të sistemit buxhetor në RSH", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj" të ndryshuar, të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në RSH", të relacionit nr 3064 prot datë 19.12.2025, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 22.12.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave dytësore të Universitetit të Sporteve të Tiranës për pagesën e kostove të stafit dhe mentorimit (20%) në kuadër të projektit "GEIN - Female Sport Leaders Promoting Gender Independent Physical Activity", në shumën 11,000 euro.
2. Rimbursimi i shumës përkatëse në momentin e disbursimit të kështit përfundimtar nga Bashkimi Evropian gjatë vitit 2026 të kaloj në favor të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë (IKSHS) dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

Dr.Marsela SHEHU

